



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 17

Datë: 09. 02. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Aktivitetet e SKQZ-së:**
- 3. Aktivitetet e ZRPPC-së:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhguesve,**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i dokumentit “Trendet zgjedhore në Republikën e Kosovës, 2009-2019”**
- 5. Këshilli për Informim Publik:**

- **Informatë rreth aktiviteteve të Informimit Publik**

6 .Të ndryshme.

1. Hyrie: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve e hapim mbledhje e 17 të KQZ-s. A kemi ndonjë çështje në lidhje me rendin e ditës?

Alim Rama: U shtrua edhe më herët por unë sugjeroj që si pik e rendit të ditës, vendimi për pranimin e votave nga diaspora si e shtune dita e fundit. Sepse edhe ashtu në kalendarin që u distribuua nga sekretariati. Dita e fundit ka qenë e premtë diku rreth orës 15:00. Deri sa në ligj duhet një dit para zgjedhjeve. Një dit para zgjedhjeve është e shtune, kështu që ta sqarojmë këtë punë tash që të mos mbesim deri në ditën e fundit.

Valdete Daka: Kemi një propozim. Kush është për këtë pikë të rendit të ditës? Vazhdojmë me rendin e ditës. Kush është për këtë rend dite ashtu siç është propozuar? Kush është kundër? Miratohet rendi i ditës...

2.Aktivitetet e SKQZ-së:

Burim Ahmetaj: Sekretariati është në përgatitje të operacioneve zgjedhore për organizimin e zgjedhjeve. Aktualisht është i fokusuar në tri operacione të cilat kanë të bëjnë me shërbimin votues, pra arritjen e pakove përmes postës, në trajnimin e trupave zgjedhor dhe furnizimin me materiale dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore. Deri më tani siç e dimë kemi arritur marrëveshje të koordinuar me secilën post që operon në Republikën e Kosovës. Postat janë, posta e Kosovës, DHL, TNT expres dhe UPS. Me të cilat kemi një procedurë të rregullt ku tërheqjen e pakove me fletëvotime përmes postës e bëjmë në procedurë të njëjtë. Pra kemi personin e autorizuar i cili bënë tërheqjen e secilës pako apo dërgesave të cilat janë nëpër postat e lartpërmendura, pra përmes personit të autorizuar bëhet tërheqja e tyre nga secila post. Pra për secilin proces dhe secilin aktivitet dhe tërheqjen e tyre do të njoftohen vazhdimisht vëzhguesit, meqenëse kohën nuk e kemi fiks në cilën kohë do të shkojmë në cilën post sepse i kemi vetëm dy persona të autorizuar mirëpo agjendën do ta përcaktojmë në përputhje dhe në bashkëpunim edhe me postën sepse na duhet të jemi fleksibel në këtë aspekt dhe mos të kemi vetëm një orar fiks. Procedura është e njëjtë për të gjitha postat dhe do të bëhet me praninë e vëzhguesve dhe në përcjellje të Policisë së Kosovës. Vendi ku do të mbahen të gjitha këto dërgesa është në hapësirën e Ministrisë së Infrastrukturës, vendi është i

siguruar mirë, i kemi 4 kamera funksionale në hapësirë të brendshme dhe e kemi një kamerë e cila e siguron hapësirën e jashtme. Pra sigurisht që është edhe Policia e Kosovës ajo që bënë sigurimin e objektit. Po ashtu kemi edhe të rregulluar edhe çështjen protokollare në sa hapet dera dhe në sa mbyllet dera e asaj hapësirës së mbajtjes së pakove, shënohet përmes protokollit ku do të jenë të pranishëm edhe vëzhguesit. Pra kjo është sa i përket masave që i kemi marr, sot pritet dërgesa edhe nga dy posta të tjera ku njëra prej tyre është posta DHL mirëpo për shkak të vonesave janë termini në 15:00 por ndoshta duhet të shtyjme në 17:30 për shkak se nuk janë të përgatitur sidomos posta DHL për të pranuar dërgesën. Me 6 shkurt janë pranuar 2,776 pako me fletëvotime nga posta e shpejt DHL. Me 8 shkurt janë pranuar 2,799 pako nga QTP dhe 179 pako nga posta numër 6 ku gjithsej janë 5,754 pako me fletëvotime. Ndërsa brenda pakove mund të ketë më shumë zarfe. Pra sekretariati parasheh që me datën 14 shkurt ditën e diele të bëhet transferimi i dërgesave nga vendi i mbajtjes në QNR ku do të bëhet edhe vlerësimi i pakove. Pra zyrtarisht puna për vlerësimin e secilës pako do të filloj me datën 14 shkurt në QNR. Sekretariati në aspekte të tjera është fokusuar po ashtu edhe në trajnimin e trupave zgjedhor, trajnimi ka filluar me ditën e diele pra është duke u zhvilluar paralelisht duke u zhvilluar në të gjitha komunat, sekretariati ka marr masa që të monitoroj këtë proces ku ka krijuar 7 njësi të monitorimit të procesit të shpërndarë në shtatë regjione ku do të mbulohet pjesa e monitorimit për secilën ditë të trajnimit të KVV-ve. Trajnimet plotësuese sigurisht se do të kemi për shkak të zëvendësimeve që janë duke ndodhur kohë pas kohe ndërsa trajnimi koordinues të kryesuesve të KVV-ve dhe menagjerëve të vendvotimit parashihet nga data 11 deri më 13 shkurt. Pra kjo është me qëllim të koordinimit dhe respektimit të procedurave prej secilës palë në secilën qendër të votimit. Ndërsa sa i përket materialeve zgjedhore deri më tani janë shpërndarë doracakët e trajnimit, pakot e trajnimit, kabinat e votimit, kutiat e votimit nëpër secilën komunë. Ndërsa materialet e tjera janë në proces e sipër dhe shpërndarja e tyre do të bëhet me datën 12 dhe 13 shkurt. Parashihet që fletëvotimet të arrijnë ditën e premte. Pra të gjithë artikujt qoftë të furnizimit apo shërbimi sipas kërkesave nga secila njësi janë në procesin e finalizimit dhe konfirmojmë që nuk rrezikohet asnjë kërkesë e njësive qoftë furnizimit apo shërbimit. Nga sot do të mund të filloj edhe printimi i begjave për stafin që do të angazhohet në procesin zgjedhor po ashtu edhe begjat për vëzhgues kështu që sekretariati ka marr masa që ti dërgoj të gjitha listat për secilin trup zgjedhor që angazhohet në ditën e zgjedhjeve të pajiset me begja dhe me dokumente identifikuese. Pra në pika të shkurtra këto ishin aktivitetet që sekretariati është duke punuar, për informata më të hollësishme mund t`ju përgjigjem.

Valdete Daka: A ka dikush pyetje për Burimin?

Sami Kurteshi: Unë dje në mbledhjen e djeshme kam shtruar një pyetje për të cilën, na është thënë se do të marrim përgjigje. Kur është publikuar lista e votuesve jashtë vendit me 2 shkurt, ne e kemi mbajtur mbledhjen atë ditë dhe KQZ-ja ka marrë vendim për publikimin e listës disa zyrtarët vetëm kanë kërkuar ta dinë kohën për arsye se PZAP-i ju kthen votuesve përgjigje se refuzimi formal ka vonësë sepse aplikimi i tyre i tyre ka ardhur në ora 19:00 i ka tejkaluar 24 orë.

Burim Ahmetaj: Sekretariati ka vëzhguar këtë proces se kur ka ndodhur me datën dhe ditën e ngjashme dhe shihet se vendimi nga KQZ-ja është marrë diku rreth orës 18:00 për çështjen e njëjtë. Ndërsa publikimi i tyre deri sa janë përgatitur listat, publikimi i tyre është bërë diku rreth orës 19:00 në ueb-faqen e KQZ-s. Pra ka marrë një kohë të shkurtër përgatitja e listave dhe publikimi i tyre në ueb-faqe. Mirëpo konfirmohet që vendimmarrja në KQZ është diku rreth orës...

Sami Kurteshi: Tash unë e kam edhe një problem. Vendim marrja në komision apo publikimi zyrtar me një vendim si ky unë e di që ajo pikë nuk ka qenë në pikat e para të rendit të ditës. Ne e kemi filluar mbledhjen në ora 17:40, 17:45 në ora 18:00 nuk ka mundur të merrej ai vendim, një. E dyta, jo të gjithë njerëzit e përcjellin me pa çfarë vendimi është marrë, por vendimi zyrtar është kur është i shtypur. Nëse PZAP-i dhe të gjithë mërgimtarët e përcjellin mbledhjen e KQZ-s, në këtë minutë është marrë vendimi nga tash fillon 24 orë është pak problem. Mesa e di unë ky instucion punon me dokumente të shtruara publike, kjo është çështja ime. Unë nuk po mund ta marr me mend se nëse nuk ka qenë pika e parë e rendit të ditës sepse atë ditë mbledhja ka zgjatur deri në ora 20:00 si paska qenë e mundur të publikohet vendimi i KQZ-s para se të fillojë mbledhja. Kjo është një pyetje shumë interesante dhe shumë me rëndësi, sepse për njerëzit atje luan rol. Sepse arsyetimi është formal. E keni tejkaluar 24 orë e keni dërguar apelin në ora 19:00, ky është problem nëse lidhemi me minuta kështu. Instucionet e administratës gjyqësore i llogarisin vendime vetëm ato kur merrem në shkrim nënshkruhen dhe publikohen por jo kur merren në mbledhje.

Alim Rama: Pasi publikimi bëhet në mënyrë elektronike, koha mundet të merret nga serveri unë nuk kuptoj pse është pengesa të bëhet saktë kur është bërë përditësimi i ueb-faqes, e para. E dyta, për shkak të pakënaqësisë dhe të një jo transparence unë kisha kërkuar nga sekretariati ti publikoj të gjitha listat e atyre të refuzuarve sepse është me rëndësi ta dimë sa veta kanë aplikuar, kush janë ata dhe të publikohet lista e atyre që ju është pranuar kërkesa dhe lista e atyre që është refuzuar sepse ende kam shumë paqartësi ku ta gjej a jam pranuar apo nuk jam pranuar. Unë e pash parë dhe nuk kuptoj që anëtarët e sekretariatit votojnë kundër zbatimit të ligjit, unë mendoj që secili prej juve duke filluar nga kryesuesja të

marrin përgjegjësi për zbatimin e ligjit. Qoftë se ligji është i qartë dhe thotë që votimi me post zgjat një dita para ditës së zgjedhjeve unë nuk e di a ka nevojë atë ta interpretojmë, a ju duhet edhe Gjykata Kushtetuese ta interpretoj këtë punë, një ditë para ditës së zgjedhjeve. Unë nuk e kuptoj tendencën nga kolegët këtu, pse ju pengon procedimi i zakonshëm të shtunën i cili është në pajtueshmëri me ligjin dhe po ashtu duke marrë parasysh që ky komision të gjithë ju e keni shkelur ligjin në disa raste. Nuk është publikuar lista preliminare me të 24, nuk ka pasur të drejtën askush për ankesë, lista atë ditë u publikua edhe nuk dihet saktë a ka qenë ora 20:00 a ka qenë 19:30 dhe sekretariati nuk është në gjendje të na jap një letër të thjeshtë të na caktoj kjo listë është publikuar në atë kohë. Ka shumë ankesa, nuk e dinë njerëzit a janë në listë a nuk janë në listë, lista u përditësua nuk ka pasur njoftime. Në anën tjetër instucioni tjetër që është bashkërisht më ju në këtë krim është PZAP-i i cili procedon gjithë kohën anesat sepse informatën të cilën e kam marrë unë është nga SKQZ-ja që tek PZAP-i merr ankesa me e-mail. Ndërkohë në ora 17:00 po vjen me vendim nuk i pranojmë ankesat me e-mail atëherë pse i ka trajtuar 200 e diçka raste. A jep përgjegjësi dikush? Dhe për votën që e jep kundër duhet të japësh përgjegjësi secili nga ju këtu. Me bindje të plotë po e shkel ligjin me dy këmbë, duke filluar nga kryesuesja. Ju lutem secili ta arsyeton pse është kundër, kjo është kërkesa ime le të arsyetohet secili pse është kundër.

Valdete Daka: Ne, japim arsyetim të gjithë para ligjit dhe të kam thënë. Për të gjitha vendimet gjithkush mban përgjegjësi edhe penale edhe morale.

Arianit Elshani: Sa i përket çështjes që e ngiti Z. Kurtoshi është çështje që është trajtuar edhe dje, në mbledhje. Në ueb-faqe mund të vërehet editimi se kur është bërë, ngarkimi i listës votuese shikojeni atë në kohën e saktë siç e tha Z. Rama të asaj dhe informojeni PZAP-in se kur është publikuar lista votuese për votim nga jashtë. Editimet vërehen kush e ka edituar dhe kur është bërë ai editim dhe njoftojeni. Po besoj që në të njëjtën kohë ka disa kërkesa që janë bërë gjatë atij orari, disa ankesa realisht në PZAP. Kështu që do ju jepet mundësia disa rasteve të tjera të trajtohen, po besoj që është shumë e thjeshtë edhe të informohen ata.

Ibrahim Selmanaj: Edhe unë kam një pyetje për kryeshefim. Ardhja e pakove dhe organizime me prezencën e vëzhguesve dhe subjekteve politike. Keni marrë një zotim se keni me vendosë kamera në objektin e Ministrisë së Infrastrukturës. A është në plan ta vendosni ndonjë kamerë aty?

Burim Ahmetaj: Kamerat janë vendosur të shtunën para arritjes së pakove të para në objektin e brendshëm. Është një monitorim me katër kamera të sigurisë që regjistrojnë dhe regjistrimi është 24 orë. Brenda nuk ka qasje askush, monitorohet dhe çdo herë që hapet dera hapet me prezencën e vëzhguesve

dhe ndërrohen shiritat e sigurisë që janë për çështje protokollare ta dimë se kush e ka mbyll derën i fundit dhe kush po e hap, është çështje protokollare. Kështu që në aspektin e sigurisë i kemi marr të gjitha masat dhe objekti është i siguruar, qoftë me monitorim brenda qoftë edhe jashtë është i mbuluar me monitorim. Ndërsa jashtë e mban sigurinë Policia e Kosovës.

Arianit Elshani: Një pyetje në lidhje me marrjen e pakove nga posta. Po e shoh që në ora 15:00 janë planifikuar në dy vende që të shkohet, në postën TNT edhe posta UPS. Janë dy ekipe që shkojnë i marrin apo është një ekip që shkon në njëërën pastaj tjetrën.

Burim Ahmetaj: Faktikisht i kemi dy persona të autorizuar të cilët e kryejnë të njëjtin shërbim dhe kanë autorizim tek të gjitha postat të shkojnë. Sigurisht që do të koordinohemi se si do të veprojmë edhe pse të njëjtit zyrtar i kemi të angazhuar edhe në operacione të tjera. Mirëpo prioritet do ti japim postave të shpejta ku konfirmohet se janë diku 500 pako të cilat janë në UPS dhe TNT. Dhe operacionet mendoj se njëherë ta marrim njëërën pastaj shkojmë me tjetrën. Por të dyta në të njëjtën kohë nuk mundemi për shkak se zyrtarët janë duke punuar edhe punë të tjera. Por sidoqoftë me të njëjtën trup të përcjelljes do të shkohet dhe me të njëjtit vëzhgues kur të bëhet ky operacion. Ndërsa për shkak të vonesave me DHL do të kemi vonesë deri 17:30 për shkak të ardhjes nga Lajciku në Shkup dhe ardhjes deri këtu dhe procesimi i tyre sepse numri është shumë i madh.

Alim Rama: Kur publikohet lista e atyre që janë të refuzuar?

Burim Ahmetaj: Do të shohim me shërbimin votues dhe do të marrim këtë informacion profesional dhe pastaj do ju japim përgjigjen përmes e-mailit. Kështu që pa u konsultuar edhe me shërbimin profesional nuk mundem, sepse të shohim listën së pari dhe do ju japim përgjigjen përmes e-maili.

Alim Rama: Dhe sa veta janë pranuar ndërkohë. Sepse po e shoh që lista është përditësuar.

Burim Ahmetaj: Sigurisht që sekretariati dhe shërbimi është duke punuar në ankesat dhe vendimet që vijnë nga PZAP-i. Është duke u përditësuar për atë arsye nuk e kemi listën e saktë se sa janë të refuzuar dhe atyre që ju është miratuar ankesa apo është marr vendim nga PZAP-i dhe ata automatikisht janë përditësuar dhe kanë kaluar në listën e të aprovuarve. Kështu që do të konsultohemi me shërbimin profesional dhe pastaj do ju njoftojmë përmes e-mailit.

Valdete Daka: Nëse nuk kemi pyetje tjetër vazhdojmë me aktivitetet e ZRPP-s.

3.Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhguesve:

Yll Buleshkaj: Tash jemi në vllugun e akreditimit të vëzhguesve para jush kemi paraqitur një raport me rekomandim për ti akredituar edhe 6,841 vëzhgues. Nga këta na mbasin diku 4,000 aplikacione për ti shqyrtuar këto dit duke përfshirë edhe një parti të madhe politike dhe OJQ e instucione të tjera të cilat janë në plotësim të dokumentacionit. Pra para jush rekomandojmë të akreditohen edhe 5,037 vëzhgues të PDK-s. 286 vëzhgues të SDU. 236 vëzhgues të NDS. 762 vëzhgues nga Kualicia VAKAT. 22 vëzhgues nga Lista Srbska. 83 vëzhgues nga YPHP. 15 vëzhgues nga media Indeks Online. 15 vëzhgues nga media vendore City Radio. 8 vëzhgues nga RTV KIM. 15 vëzhgues nga TV HERC. 15 vëzhgues nga Radio HERC. 163 vëzhgues nga OJQ-ja vendore Ortheu.

Sami Kurteshi: A ka mundësi dy fjali për këtë organizatën...?

Yll Buleshkaj: "ORTHEU", është një organizatë qytetare e regjistruar në departamentin e OJQ-ve, pran Ministrisë së Punëve të Brendshme. Si pjesë e veprimtarisë së vetë ka edhe të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrjen qytetare që plotëson kushtet minimale për të aplikuar për vëzhgues. Është një organizatë që në mënyrë të oranizueshme akrediton vëzhgues, e di që kanë qenë disa zhurma më herët por teknikisht dhe ligjërisht i plotëson kushtet për ti akredituar vëzhguesit. Kështu që ne e kemi shqyrtuar statusin me kujdes edhe njëherë dhe kemi parë që i plotëson kushtet për tu akredituar. E kanë në Prishtinë dhe në një komunë tjetër. Kemi 51 vëzhgues shtesë të OJQ-s vendore KDI. Kemi një vëzhgues të OJQ-s ndërkombëtare të Nacional Republikan Institut. Kemi edhe 4 vëzhgues të Ambasadës së Holandës. 12 vëzhgues të EULEX-it. Kemi 3 vëzhgues të zyrës ndërlidhëse të Republikës Sllovaqe në Kosovë. 13 vëzhgues të Ambasadës Gjermane. Dhe me kaq mbaron kjo lista nga 6,841 vëzhgues. Ndërsa si total janë diku 25,800. Janë edhe disa nga këto subjekte politike që i kemi akredituar dhe ka disa janë dorëzuar për plotësim prapë për shkak të gabimeve në numra personal, mos përputhjes në listën votuese por tash shumica vetëm se ka kaluar ngase kemi filluar edhe siç tha kryeshefi për shtypje të begjave në grupin e parë dhe do të filloj edhe shpërndarja.

Sami Kureshi: Një pyetje në lidhje me vëzhgues. Numri është relativisht i madh. Cili është detyrimi i KQZ-s ndaj këtyre vëzhguesve sa i përket higjienës dhe masave të Covidit. Të gjithë dimë të ruhem, por a ka KQZ-ja detyrim sa i përket preparateve.

Yll Buleshkaj: Ashtu siç ofrohet për të gjithë pjesëmarrësit në votim KQZ-ja ju ofron dezinfektues në secilin vendvotim dhe i njëjti tretman do të jetë edhe për vëzhguesit nëpër vendvotime. Nuk ka ndonjë masë më specifike se ato që u ofrohen të gjithëve edhe stafit që punon nëpër vendvotime. Të gjithë e dimë që janë

të obliguar të mbajnë maska gjatë qëndrimit në hapësirat e vendvotimit. Ne kemi përgatitur edhe një broshurë të shkurtër e cila do ti shpërndahet për secilin vëzhgues nga një kopje, e cila mban edhe një shënim në fund e cila thotë. Për shkak të masave kundër Covid edhe pse sipas ligjit mund të qëndrojnë dy vëzhgues të një subjekti brenda vendvotimit ky numër mund të zvogëlohet në mënyrë që të zbatohen masat.

Valdete Daka: Nëse nuk kemi pyetje të tjera vazhdojmë me plotësimin dhe miratimin i dokumentit të rendit zgjedhor në Republikën e Kosovës 2009-2019. E kemi pasur në e-mail adresën tonë secili. A kemi diçka. Është shqyrtuar në KOZ. Kush është për? Akreditohe...

4.Shqyrtimi dhe miratimi i dokumentit “Trendet zgjedhore në Republikën e Kosovës, 2009-2019”:

Sami Kurteshi: Unë megjithatë mendoj që jemi në fazën e zgjedhjeve dhe, unë kisha pasur dëshirë të punohet më shumë në këtë dokument dhe të jetë mundësia ti shohim të gjitha pikat dhe të diskutojmë. Nuk kam asgjë kundër, analiza të tilla unë kërkoj por, kërkoj edhe kohë që të diskutohet rreth këtyre gjërave.

Sami Hamiti: Kryetare vetëm për sqarim. Është e vërtet që kemi debatuar gjatë në KOZ, është debatuar se është një dokument shumë i mirë edhe Z. Kurteshi këtë që po e thotë që ka nevojë të shikohet edhe kjo është e drejt nga ana e tij sepse ka ardhur në KOZ në këtë fazë pikërisht sepse i nevojitet si trendë të kenë edhe vëzhguesit edhe gazetarët ti shohin pikërisht trendët për zgjedhje dhe kjo ka qenë. Sepse, ne në KOZ e kemi aprovuar, ka një muaj e se sipas gjitha gjasave kur janë shpallur zgjedhjet, dhe ka mbetur. Është e vërtet që publikimi i saj ju ndihmon edhe vlerësuesve, vëzhguesve, monitoruesve të shohin trendët që janë. Për këtë edhe është dal tani.

Alim Rama: Po e bëjë një rekomandim që sekretariati të përgatit prezantimin e dokumentit në KOZ, ndoshta në mbledhjen e radhës që të prezantohet dhe diskutohet. Sepse ne çoftë se e aprovojmë atëherë humbet edhe vlera e dokumentit. Mendoj që dokumenti meriton në këtë sallë të prezantohet shkurt prej sekretariatit dhe të tregoj cilat janë të gjeturat kryesore.

Valdete Daka: Dokumenti do të jetë në ueb-faqen tonë.

Eshref Vishi: U tha pak më herët që është shqyrtuar në KOZ, aty u shqyrtua u debatua dhe kjo çështje i takon për prezantim kryesuesit të KOZ-it.

Valdete Daka: Është në interes publik dhe atyre që merren me zgjedhje që ta kenë në ueb-faqen tonë. Ajo me siguri që do të përmirësohet, përditësohet me zgjedhjet e 2021-tës.

Sami Kurteshi: Edhe pikërisht ky arsyeimi është dashur më herët të bëhej. Edhe unë s`jam për ceremoni jam vetëm për analizën e dokumentit dhe çoftë se është bërë përpara unë e kuptoj shumë të rëndësishme. Unë nuk kam kundër asgjë por këtu është konstatuar që do të shihet, do të plotësohet, do të përmirësohet. Unë për vete nuk kam mundur ta përpunoj dokumentin prandaj po them mua po më duket shumë shpejt, shumë njëfarë zgripsis unë vetë jam në një presion kohor me marr dhe me analizuar këtë dokument. Unë nuk votoj kundër vetëm abstenoj vetëm për këtë arsye sepse dua që analizën ta kemi krejt dhe natyrisht mendoj që është shumë i mirë edhe për media por edhe për OJQ që janë të interesuara për këtë punë sepse kjo është një analizë që edhe mua po më çudit që ka ardhur pak ditë para zgjedhjeve. Asgjë skam kundër.

Arianit Elshani: Ne veçse e miratuar këtë dokument. Pajtohem me të gjithë anëtarët edhe me Z. Kurteshi që tha faktin që është dashur të trajtohet mirëpo ashtu siç e tha edhe zëdhënësi ky dokument ka qenë realisht gjatë muajit dhjetor në mos gaboj. Është trajtuar në KOZ dhe nëse jam i saktë është trajtuar dy herë dhe si dokument i ka marr edhe rekomandimet e KOZ-it meqenëse ne të gjithë kemi pasur edhe kritikën tona edhe rekomandimet tona lidhur me dokumentin. Dhe ndërkohë është plotësuar ajo dhe në momentin që i ka plotësuar kërkesat tona brenda KOZ-it ky dokument është miratuar dhe është planifikuar të publikohet në fillim të janarit dhe të vijë për rekomandim dhe aprovim në fillim të janarit. Mirëpo pasi që i kemi bërë zgjedhjet e parakohshme, meqenëse këto pika të rendit të ditës janë të zakonshëm rutinë dhe si procese të brendshme nuk trajtohen për gjatë procesit zgjedhor mirëpo nevoja e shoqërisë civile dhe e mediave ka bërë që kjo tash edhe të futet.

Unë, pajtohem me të gjithë ju që është dashur të jetë disa javë më parë të publikohet, mirëpo edhe gjithë anëtarët të kenë qasje dhe ti japin rekomandimet e tyre. Por në parim e mbështes dhe mirë që qëndruam gati mediave dhe shoqërive civile që ta kenë këtë dokument para ditës së zgjedhjeve.

Valdete Daka: Megjithatë mbetet pas ditës së zgjedhjeve kjo analizë të përditësohet me zgjedhjet të cilat janë duke u mbajtur dhe natyrisht çoftë se ne kemi ndonjë çështje tjetër sa i përket kësaj analize të bëhet edhe njëherë. Qoftë se nuk kemi diçka tjetër mundemi të vazhdojmë me këshilli për Informim Publik...

5. Këshilli për Informim Publik:

Informatë rreth aktiviteteve të Informimit Publik:

Artan Asllani: Këshilli për mbikëqyrje të Informim Publik ka mbajtur mbledhjen e 8 me 8 shkurt ku ka miratuar 4 video. Njëra është miratimi i videos për votimin me masa mbrojtës të Covid19. Video e dytë është për mënyrën e votuesit të infektuar me Covid. Edhe video tjetër është, mesazhi drejtuar votuesit për ta shfrytëzuar të drejtën e votës dhe video spoti për vëzhguesit. Video me vëzhguesit është e njëjtë më broshurën që e përmendi më herët edhe Ylli se çka kanë të drejt dhe çka nuk kanë të drejt vëzhguesit në ditën e zgjedhjeve. Këshilli për Informim Publik ka miratuar gjithashtu edhe media planin për radio dhe televizione dhe gjithashtu ka miratuar planin për sponsorizimin e produkteve nëpër portale dhe rrjete sociale. Këshilli për informim publik gjithashtu ka miratuar dy postera të cilat do të shpërndahen nëpër qendrat e votimit në ditën e zgjedhjeve. Njëri prej posterave është dizajni dhe përmbajtja për masat mbrojtëse për mënyrën e votimit dhe mbrojtjen nga Covid19. Dizajni i dytë është për votuesit me asistencë. Gjitha këto produkte do të shfaqen nëpër videot televizionet në, RTK1, RTK2, RTK3, KTV, RTV 21 dhe për gjuhën serbe në TV MIR dhe siç i keni nëpër raporte.

Alim Rama: Produktet pak a shumë janë aprovuar në parim në fillim të janarit në strategjinë e komunikimit. Por ndërkohë pas gjithë këtyre rrethanave edhe një video që e kundërshtova në Këshill për Informim Publik e ka të bëjë, sepse ju kryesuese vetë keni deklaruar se jeni personi më i urreyer në Kosovë dhe mua nuk po më duhet e arsyeshme që tash video ftesa me ardhur nga një person që e ka humbur kredibilitetin. Kështu që unë kisha kërkuar që KQZ-ja si e tërë ta bëjë ftesë kolektive për të thirrur votuesit në zgjedhje...

6. Të ndryshme!